

ENTELA KAZAZI (SHINGJERGJI)

NGJYRIMI EMOCIONUES NË LIGJËRIMIN E SHKUJDESUR TË TË RINJVE

“Nuk ka gjuhë të të rinjve, sepse nuk ekziston rinia si grup homogjen shoqëror”¹

Vështirë që studiuesit në fushë të sociolinguistikës të bashkohen të gjithë me pohimin e mësipërm. Ashtu edhe ne, pasi jemi thelluar në literaturën përkatëse, e kemi pasur të vështirë të mbajmë një qëndrim të prerë. Edhe pse na duket më i saktë pohimi i Arno Scholz-it, nuk e kishim të lehtë të anonim nga ky i fundit. Gjovalin Shkurtaç në librin e tij “Sociolinguistikë e shqipes” përdor për të emërtuar grupin shoqëror të të rinjve adoleshentë termin “Peer group”. Në këtë suazë, për të përcaktuar ligjërimin e të rinjve autori përdor (jo pa rezerva), emërtime si “zhargoni i shkollarëve dhe i studentëve”, e më tej, argo, të folme të fshehta apo të folme kuturore².

Përcaktimi i ligjërit të të rinjve me plot gojën si “zhargon” e aq më pak si gjuhë më vete brenda gjuhës është i dyshimtë. Silvero Noveli, duke përdorur një metaforë nga bota ushqimore, e paraqet ligjërimin e të rinjve si një brumë që krijohet nga bashkimi i miellrave të llojeve të ndryshme. Rezultati final është shkrirja e elementeve heterogjene për të përfutur një brumë homogjen, ku ndihen, megjithatë, shijet e përbërësve parësorë. Për shkak të këtij pështjellimi terminologjik, kemi zgjedhur të përdorim në punimin tonë vetëm emërtimin “Ligjërimit të të rinjve”.

Duhet pasur parasysh në këtë kontekst se kur flitet për të rinjtë, është e udhës të përcaktohet me saktësi se cilit fragment të brezit të të rinjve i referohemi. Të rinjtë janë një makro-grup i bashkësisë shoqërore, i ndarë në segmente. Është e kuptueshme që mosha është një faktor socio-demografik që lidhet ngushtë me sjelljen gjuhësore. Në interes të studimit tonë është ligjërimi i të rinjve të gjimnazit, pra grupmosha 15-18 vjeç. Kemi zhvilluar për këtë punim anketime në disa prej gjimnazeve të qytetit të Elbasanit. Qëllimi është që të hetohen nga afër tiparet e ligjërit të shkujdesur të të rinjve të kësaj grupmoshe, më konkretisht ngjyrimi emocionues si përbërës ose jo i kuptimit të fjalëve, rrugët dhe mënyrat se si fjalët dhe shprehjet e përdorura prej tyre fitojnë ngjyrim emocionues.

¹ Arno Scholz, *Italienisch*, 2005, nr 2, f. 69.

² Shih për më tepër Gj. Shkurtaç, *Sociolinguistikë e shqipes*, Morava, Tiranë 2009, f 119, f. 238 dhe më pas f. 252.

Ajo që dihet tashmë është që të rinjtë flasin mes tyre duke përdorur një lloj leksiku si edhe shprehjesh të cilat duket kanë si synim të përjashtojnë të rriturit, duke evituar të kuptuarit prej tyre. Qëllimi final është të arrihet një lloj personalizimi i gjuhës. Kjo, sigurisht për t'u shkëputur e për të lënë jashtë botës së tyre të rriturit e për të krijuar një lloj individualiteti.

Në leksemanikën e të rinjve gjejmë rëndom fjalë me ngjyrim emocionues, që përveç vlerës shënuese, kanë edhe një element të mbishtresuar, ngjyrimin emocionues, pozitiv ose negativ. *Ngjyrimi emocionues në fjalë është tregues i qëndrimit të folësit ndaj asaj që përmend, vlerësimi subjektiv i dikujt a diçkaje.*³ Përmes ngjyritimit emocionues, folësi, bashkë me informacionin, synon që të shprehë edhe vlerësimin, qëndrimin e vet emotiv për atë që thotë. Ndjenjat e larmishme të individit folës jepen përmes nuancave nga më të hollat të ngjyritimit emocionues. Për punimin tonë kemi shfrytëzuar material të bollshëm të mbledhur përmes anketimeve në gjimnaze të ndryshme të qytetit të Elbasanit. Për të qenë sa më afër origjinalit, kemi zgjedhur që t'u qëndrojmë besnikë trajtave dialektore që kemi hasur gjatë kësaj pune. Le t'i hedhim një sy rrugëve të shprehjes së ngjyritimit emocionues në ligjërimin e të rinjve:

1. Fjalë që kanë ose e marrin shumë shpejt ngjyrimin emocionues.

Këtu futen edhe emrat e disa sendeve tek të cilat bien në sy cilësi lehtësisht e dallueshme nga të tjerat si:

a. **Fjalë që tregojnë cilësi pozitive si mahnitje dhe admirim:** *yll, kukull, fibër* (për një vajzë me trup të bukur e të ngjeshur, ose: *kompesatë* (pa gjoks), *budalla, budall, debil, psikopat, gjysmak, kafshë, skizofren, matuf, injorant, e çmendur, prostitutë, horr, tapë, dru, pykë, fyell, legen* (njeri i paqëndrueshëm, pa vlerë), kur mbahet në qëndrim **negativ, përçmues**.

b. **Emrat e frutave dhe luleve që përdoren për lavdërim,** zakonisht për vajzat, me nuanca **përkëdhelie, pasioni:** *luleshtrydhe, lule, pjeshka*. Kur përdoren për djemtë marrin nuanca **ironizuese:** *karafil* (për dikë të pazotë), etj.

c. **Emrat e disa perimeve, që përdoren kryesisht për sharje, ironizim,** duke u kthyer në nofka për njerëzit: *patëllxhani* (hunda e madhe), *domatja* (gjoksi i madh), *kungulli* (që e ka kokën bosh), *lëpjeta, prasi, spinaqi* (tallje për mësuesit), etj.

d. **Emërtimet e kafshëve që përdoren për sharje, përbuzje:** *derr* (për një njeri të trashë) *lepur, dele* (frikacak), *viç, pinguin, midhje, hajvan insekti, qen, papagall* (për mësuesit), *gaforre, laraskë, gorrillë, majmune, çitë, gomare, ujk, gjirafë, bubuzhel* (vajzë e shëmtuar), por edhe me **nuanca lavdërimi e mahnitjeje:** *sorkadhe, pelë* (për vajza me trup të bukur), etj.

f. **Pasthirrma:** *O shef!, O biznesmen!, O mret!, O qejf!, O llak!, O bishë!, O bot!, O la!, O lash!, O king, O dak!* (për miqtë, për të **shprehur nuanca**

³ J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Shblu, Tiranë 2002, f. 108.

miqësie, përkrahjeje, dashamirësie etj.). Ose: *yyyy!; O Zot, O Zot!* (për vajza të bukura, për të shprehur nuanca **mahnitjeje, entuziazmi, përkëdhelie**), *uffff!, pffff!, bahhh!* (**me nuanca pakënaqësie, bezdie** ndaj shkollës), *obobo! (klub nate), hallall!, hec aty!* (për të shprehur **nuanca miratimi, admirimi, përgëzimi, urimi**), *iii ça ftyre!* (**me nuançë përcmuese, neverie**).

g. Disa fjalë të huazuara e të të vjetëruara, kryesisht nga turqishtja. Këto, janë pjesë e fondit të vjetëruar të leksikut, që përdoren më rrallë dhe gjithmonë të ngarkuara me konotacion (kryesisht negativ) me qëllim që folësi të shprehë sa më qartë qëndrimin e tij emocional dhe të realizojë qëllimin e ligjëratës. Përgjithësisht ato kanë ngjyrim **përcmues**, si: *syrtik, dyrdyl, derdimen, xhinaze, dyst taban*, por edhe **admirues**, si: *marshalla!, aman aman!*, etj.

h. Disa fjalë të huaja, kryesisht nga anglishtja: *hot, sexy, nice, miss, star, trendy, lucky, party, crazy*; nga italishtja: *firmato, frate, amore / amorja*; nga spanjishtja: *ermanita, pappi chulo, mamita* (me nuanca **admirimi, adhurimi, përkëdhelie**); por edhe *travestit, ritardato, loco* etj. (me nuanca përcmuese).

2. Mjete fjalëformuese si: prapashtesat me nuanca **përkëdhelie** në përdorime të tipit: *mamka, mushi, syçkat, babuç, motrush, motla, kecush, byrazerka* (motra), *zoçka, zogzë* (vajzë e bukur) apo **përkeqësuese, tallëse, sharëse, përbuzëse, neverie**: *shtëpiaks, burracak, shpifse, shpifarake* (vajzë e shëmtuar), *leshko, malok, zhulaq, gjysmak, lekist, qylaxhi, shancaxhi, lekxhi, frikso* (frikacak), *sherrist, morraxhi, ngordhalaq*, ose me **shaka, përmes eufemizmit**, droga e fortë quhet *kuqaloshe*.

3. **Togfjalësha ku njëra fjalë ka kuptim të figurshëm** e ngushtësisht të kushtëzuar në një lidhje të caktuar konkrete fjalësh⁴. Zakonisht kjo gjymtyrë ka funksion përcaktori dhe vlerë mbiemërore. Kemi të bëjmë me bashkime të parregullta fjalësh që formojnë togje shumë të rrudhura, dhe lidhje asociative krejt të papritura ose kalime fjalësh në grupe tematike të pazakonshme⁵. Kuptimi i togut kalon në radhë të dytë dhe dobësohet roli shënjes; kryesore këtu është qëndrimi emocional ndaj asaj që shënohet, vlerësimi subjektiv dhe jo rrallë, i rëndë dhe i fortë. Kështu, për të shprehur nuanca **pesimizmi, zhgënjimi, mërzie**: *jetë qeni, fat qeni, fat m..i, shans derri, fat leshi* (pa fat); **me nuanca emocionuese përbuzjeje**: *çun rruge, çun farash, çun pa busull, gomar pa tru, dhi e çmendur* (i çmendur), *shefi i hiçit* (i papunë) *rrush mbrapsht* (vajzë e shëmtuar), *boli i filanes* (i dashuri), *budall tresh, budall tek, njeri i palexuar, surrat i salduar, rob fallco, zara veç, koha e qepës* (jashtë mode), *kriza e lagjes* (i forti), *dora e dytë* (vajzë e kaluar në moshë), *copë lyçi*

⁴ J. Thomai, *Fjalori frazeologjik i gjuhës shqipe*, Shkenca, Tiranë 1999, f. 10.

⁵ Shih për më tepër Xh. Lloshi, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, SHBLU, Tiranë 2001, f. 177.

(budalla); **me nuanca ironizuese**: *çun pasarelash, çun deputeti, çuna qoftesh* (jo shokë), *shaka e natyrës* (homoseksual), *çarje veshësh* (lëndë mësimore), *shteti i shkollës* (drejtori), *qeif gjeli* (kur del me një vajzë), *çun haram*; **me nuançë admirimi**: *derr femre, gocë metalika, moderne e avancume* (me tatuazhe), etj.

4. Janë të shpeshta përdorimet **eufemistike** në ligjërimin e të rinjve, **me nuançë tallëse e ironizuese** por gjithnjë në përpjekje për ta zbutur e zbehur kuptimin e fortë përmes eufemizmit. Kemi hasur gjatë vëzhgimit tonë përdorime të tilla si: *reçel, lule, miell, niseshte, kallam, tym, burbuqe* (për drogën); *parukja* (për dikë që përdor paruke), etj.

5. **Përdorime metaforike me nuanca mospërfilljeje**. Këtu fjalët pësojnë ndryshime semantike deri edhe në zbrazje të kuptimit të drejtpërdrejtë: *tapë, sëpatë, dru, uthull, gërnetë, dekan* (për një person të dehur); *kaçavidë, sokol, adrenalinë* (për një njeri që që grindet kollaj); *i krisur, krizë* (që nuk ka frikë të grindet); *semafor, viktimë* (për një njeri të papunë); me nuançë **habie e kënaqësie e admirimi**: *parakolp, bombë, granatë* (për një gjoks të madh), etj.

6. **Njësia frazeologjike** zë një vend të konsiderueshëm në leksikun e shkujdesur të të rinjve. Ajo është në fakt një njësi nominative (shënuese) dhe ekspresive (shprehëse). Në shumicën e njësive frazeologjike elementi konotativ është dominues, thuajse i përhershëm⁶. Në ligjërimin bisedor dhe të shkujdesshëm të të rinjve, shpesh funksioni nominativ del në plan të dytë. Kemi gjetur në gojën e të rinjve shprehje **me nuanca kënaqësie apo çiltërsie** kur gjenden pa punë: *dredh zinxhirin, rri të rrimë, pallë ariu*; të tjera me **nuanca negative, qortuese**: *zar më vete, ka dalë nga shinat*; **me ngjyrim urrejtjeje, lehtësimi** etj.: *i dhashë duart, e hoqa qafe, i vuna kapak* (ndarja nga i dashuri / e dashura), *ka dorë* (hajdut); **me ngjyrim përçmues**: *copë mishi, nuk ha pyka, nuk di nga lidhet gomari, nuk ia var trajsën*, etj.

7. Dimensionin i zbavitjes dhe i lojës zë një vend të rëndësishëm në ligjërimin mes të rinjve. Ata që përdorin gjuhë origjinale dhe kanë fantazi krijuese, janë gjithnjë shumë popullorë dhe të vlerësuar nga grupi. **Shprehjet e figurshme të rastit ose “fjalët fluturake” apo “fjalëshpejtat”** janë gjithmonë “në modë” ndër të rinjtë dhe përdoren për t’i treguar dëgjuesit pjesëmarrjen në të njëjtën klasë shoqërore⁷. Ato shpesh kanë trajtën e njësive frazeologjike, sepse krijohen për analogji sipas modeleve ekzistuese në gjuhë. Zakonisht përdoren **me nuanca shakaje**, për të krijuar ilaritet në situata të çliruara nga tensioni. Të tilla janë: *tall bizhdilet* (me vlerë eufemistike), *no many, no fany, no lek, no brek; o lek ku je* (i papunë), *dëmton rëndë shëndetin* (shkolla), *mirëmëngjes interes* (interesaxhi), *i ka kombinu fjongot me çorapet* (i pirë), *grupi “rrik dik me drita fik”, çun-çun ka dalë ligji* (për

⁶ J. Thomaj, *Fjalori frazeologjik i gjuhës shqipe*, Shkenca, Tiranë 1999, f. 7.

⁷ T. Toska, *Elemente të frazeologjisë shqiptare në mendësi*, Naimi, Tiranë, 2014, f. 56.

homoseksualët), *firma xhiku- butiku* (diçka e blerë në tregun e lirë rom), *lin nji, kap nji* (e përdalë), *të vdes unë ...* (si pasthirmë), *e dua cigaren sepse është e vetmja që digjet për mua*, **me nuanca tallëse dhe përbuzëse**: *është fresk fare* (i çmendur), *dhe tavolina kupton më shumë se ky* (i trashë), *nuk e do Zoti* (pa fat), *mat rrugët, vërdallisu kot, jam zero, pa kokërr leku, rehat fare, ai i Omonias, shefi i hiçit* (i papunë), *ballkon dy me dy* (vajzë me gjoks të madh), *qenka fushë, i ka harrru cicat në shpi, për ta përplas pas murit* (vajzë me gjoks të vogël), *më iku fija* (sipas nj. f. më iku filli), *i ka kaluar afati* (për një vajzë / djalë në moshë të madhe), *i ka kalu traktori sipër, e ka shtyp treni, e paska ba Zoti për çunin e vet* (për një vajzë jo të bukur); *17 maji* (për një homoseksual); *ma hoqi pinin / pukun, m'u dogj pini, më iku zari* (kur çuditësh, habitesh, mërzhitesh, mbaron durimi); *ka ik për skrap* (i droguar), *s'bëhet më, firmosi vdekjen* (për dikë që fejohej), *nuk i punojnë qelizat* (i çmendur), *je ba tapore* (i dehur); **me nuanca kërcënimi, armiqësie në grindjet verbale**: *ta çaj ballin, mos ta shof ma surratin, ik vdis* (zhduku); **me nuanca mburrjeje**: *e mbarova dikë* (e turpërova), *tatuazh i fshim* (ish e dashura), etj.

8. Bota e televizionit, e spektakleve të humorit, e filmave artistikë dhe vizatimorë, e muzikës, e betejave politike, është jashtëzakonisht joshëse dhe shpesh sjell si prurje në ligjërimin e të rinjve, që janë pjesa më e ndjeshme dhe lehtësisht e ndikueshme, fjalë dhe shprehje të gatshme, emra personazhesh të njohur që bëhen përfaqësues të një tipari të spikatur. Në këtë suazë, do të veçonim disa batuta të gatshme, që janë shkëputur përfundimisht nga konteksti origjinal ku janë ngjizur dhe riprodhohen në situata përherë të reja, duke sjellë me vete një qëndrim a vlerësim subjektiv të folësit. Interlokutorët e aktualizojnë kuptimin e saj përmes një asosacioni të situatës së njohur, kur është prodhuar batuta dhe situatës së re në të cilën janë pjesëmarrës. Përmendim këtu: *plasën çokollatat* (shaka), *bace u kry* (**besim dhe vendosmëri**), *gishtat e Sal Berishës* (**tallje**, për pantallona të ngushta a streçe), po unë për të mirë e njoh veten; a ba shqiponjë (**me admirim** për dikë që ka fat, është i zoti). Burgu quhet me **nuanca shakaje** dhe shpesh me drejtim eufemistik: *Jeta funit, Big brother*; karaktere të ndryshme identifikohen me personazhe të njohur për të shprehur nuanca të ndryshme emocionuese. P.sh. për të shprehur një **qëndrim mosvlerësues e tallës** ndaj një vajze jo të bukur përdoren emrat e personazheve të njohur: e *shëmtuara Beti* ose thjesht Beti (sipas telefilmit të njohur), për të mbajtur **qëndrim tallës, ironizues, për të shprehur bezdi, përbuzje, urrejtje, ndonjëherë edhe frikë** nga lënda mësimore ose mësuesit, të rinjtë përdorin kryesisht emrat e personazheve të botës së spektaklit, të politikës, të filmave vizatimorë, e tek-tuk të përditshmërisë në qytetin e tyre: *Luze, Bukra, Edra, gogol, Luçiferi, Shtriga, Kuçedra, Kuazimodo, përbindësh* (për mësuesit). *Goku, Enver, armiku i popullit, e ka lënë 97-ta prapa* (**me nuancë përçmimi** për dikë që nuk ndjek

modën), *Hitler, Duçja Gadafi, Miri i Xhikes, Mond Koseni* (një ish-komisar i zoti policie në qytetin e Elbasanit, **me nauncë frike përzier me admirim** për drejtorin e shkollës), etj.

Ndonjëherë, për të marrë nuanca të veçanta **ironizuese dhe tallëse** disa emra përdoren si antonime të kuptimit të tyre të vërtetë, si P.sh.: *ylli i botës, Ciljeta, Mamica, Rihanna, Noyzi, James Bond, Çaknors* (nofkë për mësuesit), etj.

9. Në fushën e fjalëformimit bie në sy përdorimi i disa fjalëve të prejardhura dhe i kompozitave që mund të konsiderohen si neologjizma. Këto janë përgjithësisht të rastit, dhe si rrjedhojë të paqëndrueshme në gjuhë, kanë vlerë të dyfishtë, nominative dhe ekspresive, synojnë të emërtojnë dikë sipas tiparit mbizotërues, por edhe të shprehin qëndrim apo vlerësim subjektiv ndaj tij. Të rinjtë priren të shprehin përmes tyre **nuanca përkeqësuese negative**: *sterrsterr* (frikacak), *o gërmëzues* (i dehur), *kokëtas, kokëshpullë, kokërrujt* (që bën sherr), *kokëpalarë, surratgërvishme, surratshpifme, sybibë, sykuq* (i dehur), *cicëtharë* (pa gjoks), etj.

Siç mund të vihet re nga prurjet më sipër, ligjërimi i të rinjve është padyshim më emocional se ai standard. Për të rinjtë është thelbësor vlerësimi subjektiv i realitetit, komunikimi i fortë dhe plot ngarkesë emotive dhe kuptimore (e zakonshme dhe e kuptueshme kjo për moshën). Të rinjtë kanë nevojë të shprehen plot vrull, energji, emocionalitet. Kjo dëshmon se ligjërimi i tyre nuk është thjesht një mënyrë për të komunikuar, por edhe një mjedis ku ata shprehin dhe zhvillojnë personalitetin, ndjenjat, opinionet mbi botën, idetë e tyre dhe, me sa duket, ligjërimi i zakonshëm dhe formal nuk u mjafton, ose nuk gjykohet si i përshtatshëm prej tyre, për të realizuar këtë qëllim.

Bie dukshëm në sy është se leksiku i të rinjve përfaqësohet më shumë prej fjalëve me ngjyrim emocional negativ sesa pozitiv. Kjo ndodh për arsye se ky lloj ligjërimi jo rrallë manifeston një marrëdhënie konfliktuale me botën e jashtme. Paqëndrueshmëria sociale dhe emotive bën që ligjërimi i të rinjve të marrë më shpesh ngjyrim të forta negative, dhe agresive. Fjalët fyese për pamjen e jashtme gjenden më shumë në fjalorin e djemve sesa të vajzave, dhe jo rrallëherë kanë kuptime ekuivoke dhe insinuata të natyrës seksuale. Kjo lidhet me karakterin e djemve që tërhiqen më shpejt dhe më shumë prej formës sesa prej përmbajtjes. Leksemantika femërore nuk duket kaq e gjallë dhe prodhimore sa ajo e djemve. Fusha kryesore e përdorimit dhe e krijimtarisë lidhet kryesisht me marrëdhëniet shpirtërore.

Studiuesit e krahasojnë ligjërimin e të rinjve me një meteor të shpejtë, që zgjat e shumta një dhjetëvjeçar, pastaj ndryshon. Ai evoluon me një ritëm të shpejtë, fjalët dhe shprehjet desemantizohen dhe risemantizohen, fitojnë ngarkesa të theksuara figurative dhe shprehëse. Bota kulturore dhe ajo shpirtërore e të rinjve “vjetërsohet” e konsumohet dhe si rrjedhojë ka nevojë të përditësohet shpejt. Efekti i të ashtuquajturit “konsumizmi gjuhësor” mund të ndihet shumë shpejt, madje për një stinë a dy, fjalët dhe shprehjet e këtij

Ngjyrimi emocionues në ligjërimin e shkujdesur të të rinjve

ligjërimi ka gjasa të mos jenë më të përshtatshme për të shprehur idetë dhe emocionet e të rinjve të këtij brezi në fjalë. Kjo pasuri e sotme do të jetë nesër diçka e largët dhe e harruar, ose siç do të shprehej një i ri “Një tatuazh i fshim”.

BIBLIOGRAFI

Arno Scholz, *Italienisch*, 2005, nr. 2.

Gj. Shkurtaç, *Sociolinguistikë e shqipes*, Morava, Tiranë 2009.

J. Thomaj, *Fjalori frazeologjik i gjuhës shqipe*, Shkenca, Tiranë 1999.

J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Shblu, Tiranë 2002.

T. Toska, *Elemente të frazeologjisë shqiptare në mendësi*, Naimi, Tiranë, 2014.

Xh. Lloshi, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Tiranë 2001.

